



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prudato Received/Delivury	20.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHICK	2269/2022		1/4	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.224/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.224/2022 të datës 11.03.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 20.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.224/2022 e datës 11.03.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, që ankuesit ti realizohet kompensimi i pagës sipas Ndryshim plotësimit të Akt emërimit të datës 01.05.2020 dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 22.12.2021 e deri në zbatim të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] ka qenë i punësuar në Komunën e Ferizajt, sipas kontratës me numër 296/2010 të datës 31.10.2011, në pozitën Zyrtar administrativ dhe financiar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me datën 01.05.2020, Kryetari i Komunës së Ferizajt ka nënshkruar plotësim ndryshimin e akt emërimit për ankuesin në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit në Drejtorinë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër. Ankuesi me datën 22.12.2021 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Ferizajt, për zbatimin e ndryshimit dhe plotësimin të akt emërimit të datës 01.05.2020 si dhe kompensimin e diferencës sipas koeficientit 9. Menaxherja e Personelit në Komunën e Ferizajt, në përgjigje të kërkesës së ankuesit me datën 25.02.2022 ka njoftuar të njëjtin se kërkesën për zbatim të koeficientit të pagës sipas Akt Emërimit të datës 01.05.2020, me datat 08.02.2021, 08.04.2021, 07.05.2021, 09.08.2021 dhe 10.01.2022 e ka përcjellë tek Ministria e Administratës Publike, mirëpo këto kërkesa nuk janë realizuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Zyrës së Personelit të Komunës së Ferizajt, brenda afatit ligjor respektivisht me datën 11.03.2022, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me harmonizimin e koeficientit sipas akt emërimit të datës 01.05.2020 si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive të pagave nga data e marrjes së plotësim ndryshimit të akt emërimit të datës 01.05.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 15.03.2022 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Ferizajt, ndërsa Këshilli me datën 31.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1296/2022 të datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje e datës 25.02.2022 nga Komuna e Ferizajt; Formularin e datës 10.01.2022; Formularin e datës 08.02.2021; Formularin e datës 08.04.2021; Formularin e datës 07.05.2021; Formularin e datës 09.08.2021; Formularin për kërkesë apo ankese të datës 22.12.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 22.12.2021 e parashtruar për Komunën e Ferizajt; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.05.2020; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 18.06.2013; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 05.09.2012; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.07.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 31.10.2011; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.03.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 31.03.2022 nga Komuna e Ferizajt me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.07.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 05.09.2012; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Përgjigjen në kërkesën e ankuesit të datës 25.02.2022 nga Komuna e Ferizajt; Formularin PDP për përkrahimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 28.06.2012; Formularin PDP për përkrahimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 03.01.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së është e **pjesërisht e bazuar** ankesa e ankuesit **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, si dhe nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, ku është përcaktuar se: *“ Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën për numrin e*



orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”, andaj në kuptim të këtyre dispozitave si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ushtron pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Kadastrit sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.05.2020 me koeficient nëntë (9) të pagës, Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 01.05.2020.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për njohje retroaktive të koeficient gjegjësisht nga data e lëshimit të Akt Emërimit të datës 01.05.2020, Kolegji duke u nisur nga fakti se ankuesi kërkesën e për realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 01.05.2020 e ka parashtruar pranë organit të punësimit me datën 22.12.2021, konstaton se ankesa përkitazi me këtë pretendim është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, andaj pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Kryetari i Komunës së Ferizajt është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankuesit ti realizojë pagën sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit për pozitën përkatëse dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 22.12.2021, gjegjësisht nga data e parashtrimit të kërkesës pranë Zyrës së Personelit në Komunën e Ferizajt për zbatim të plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.05.2020.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.224/2022, datë 20.04.2022

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



*Vendimi i dërgohet:*

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.